

Zvicra ndihmon dy shkolla dhe bibliotekën e Vitisë



Viti, 13 nëntor - Qeveria zvicerane, përmes "Helvetas Swiss Intercooperation", ka ndihmuar gjimnazin "Kuvendi i Lezhës" dhe shkollën e mesme teknike "Jonuz Zejnullahu" me banka dhe karrige për nxënës. Në këtë mënyrë do të mundësohet një proces më cilësor edukativ-arsimor, pohojnë përfaqësues komunalë.

Merita Barileva, zyrtare e organizatës Helvetas, u shpreh se këto dy projekte në shkollat e mesme janë realizuar në kuadër të mbështetjes që qeveria zvicerane po mbështet arsimin në Kosovë, me ç'rast mendohet të përmirësojë kushtet për nxënës në këto dy shkolla.

"Përveç këtyre projekteve, kemi ndihmuar edhe bibliotekën komunale, duke e plotësuar me tituj të rinj që kanë qenë kërkesë e fëmijëve për këta libra. Gjithsejtë janë diku rreth 300 tituj, prej të cilëve një pjesë e tyre do të shkojnë në degën e kësaj biblioteke në Pozheran dhe Sllatinë", tha Barileva për rajonipress.